

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË UJËSJELLËS BULQIZË SH.A.

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujësjele Sh.a. Bulqizë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe mjedisore” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2013 deri me datë 31.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr 116, datë 14.09.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 513/7, datë 14.09.2015 dërguar z. Sami Bruçi, Drejtor në Ujësjele SHA Bulqize, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi u konstatua se emërimi i anëtarëve në këshillin mbikëqyrës nga asambleja e aksionarëve, nuk është bërë duke zbatuar kriteret e vendosura në statut, duke siguruar njohuritë nevojshme profesionale, administrative dhe juridike të këtyre anëtarëve. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 11 -13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga asambleja e ortakëve që emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të bëhet duke zbatuar kriteret e vendosura në statut.

Menjëherë dhe vazhdimisht

2. Më datë 19.01.2015 ka mbaruar afati i kontratës së administratorit të shoqërisë Ujësjele Sh.a. Bulqizë dhe Këshilli Mbikëqyrës nuk është mbledhur për zgjedhjen e administratorit të ri në kundërshtim me nenin 21 të shoqërisë mbi kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës. Mungon kontrata e Këshillit Mbikëqyrës me Drejtorin e Përgjithshëm të Ujësjele SH.A. Bulqizë për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë në kundërshtim me nenin 21, pika 3 të Vendimit Nr.678, datë 3.10.2007, Për një shtesë në vendimin Nr. 271, datë 9.5.1998 të këshillit të ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 11 -13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës për zgjedhjen e administratorit të ri sipas nenit 21 të statutit të shoqërisë. Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës për lidhjen e kontratës me administratorin e ri të shoqërisë.

Brenda datës 15.10.2015

3. Nga ana e Këshillit Mbikëqyrës nuk janë përpiluar treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit fiskal, dhe ja propozon asamblesë së ortakëve, si element bazë i vlerësimit të punës së drejtorit të shoqërisë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 11 -13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga asamblea e ortakëve që Këshilli Mbikëqyrës të përpilojë treguesit e performancës që duhet të arrijë shoqëria në fund të vitit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

4. Në lidhje me drejtorin e përgjithshëm:

-Nuk janë përpiluar raporte financiare tre mujore drejtuar Këshillit Mbikëqyrës.

-Nuk është realizuar përgatitja e buxhetit dhe raportit të progresit mbi operimin dhe mirëmbajtjen sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.

-Nuk janë përpiluar plane vjetore pune dhe mirëmbajtjeje.

-Nuk ka raporte vjetore të mirëfillta performance, por ka vetëm pasqyrim të treguesve teknik dhe ekonomik.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 11 -13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Këshilli Mbikëqyrës që administratori i shoqërisë të plotësojë raportet vjetore, raportet për realizimin e treguesve ekonomiko financiarë.

Menjëherë dhe vazhdimisht

5. Planifikimi është bërë i pastudiuar dhe jo i detajuar, në relacionet dhe në raportet mbi realizimin e programit ekonomik të Sektorit Ekonomik, nuk jepen shpjegime të sakta mbi arsyet dhe faktorët e realizimit ose mosrealizimit të treguesve të planifikuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr 14 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës që administratori i shoqërisë bashkë me degën ekonomike të kryejë planifikimin e saktë në relacionet dhe raportimet e programit ekonomik.

Menjëherë dhe vazhdimisht

6. Nuk ka programe zhvillimi të hartuar, bazuar në treguesit historik, në iniciativat, perspektivat e investimeve, por kanë patur prioritet vetëm treguesit e prodhimit, faturimit dhe arkëtimit duke i planifikuar me rritje, por pa argumentuar nga ana sasiore apo cilësore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr 14 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës që administratori i shoqërisë bashkë me degën ekonomike të përpilojë programet financiare afatmesme, ku të përfshihet plani strategjik i zhvillimit të shoqërisë, të përcaktohet misioni, matrica e qëllimeve strategjike, objektivat, fushat prioritare si dhe projektet.

Brenda datës 31.12.2015 dhe Vazhdimisht

7. Nuk ka përllogaritje të sasisë së ujit që humbet nga lidhjet e paligjshme që janë në rrjetin aktual që administrohet nga shoqëria, pasi janë futur në humbje dhe shpërdorimet e ujit nga lidhjet e paligjshme dhe nga mosfaturimi i ujit të cilat janë konsideruar si humbje tekniko-ekonomike. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr 14 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës që administratori i shoqërisë bashkë me degën ekonomike të kryejë përllogaritjen e sasisë së ujit që humbet nga lidhjet e paligjshme që janë në rrjetin aktual që administrohet nga shoqëria.

Brenda datës 31.12.2015 dhe Vazhdimisht

8. Mungojnë të dhëna të sakta për llogaritjen e humbjeve tekniko-ekonomike në rrjet, për arsye se në burimet e prodhimit të ujit, stacionet e pompimit, në rrjetet e shpërndarjes deri te konsumatori nuk janë instaluar sisteme të matjes. Nuk janë bërë investime dhe nuk janë marrë masat e duhura për të evituar humbjet e ujit që vijnë nga rrjedhjet në depot e ujit të dukshme dhe jo të dukshme, humbjet nga lidhjet e paligjshme, humbjet për shkak të rrjedhjeve në linjat e transmetimit të cilat kanë humbje teknike (reale) por llogariten me vlerësim. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr 14 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga administratori për vendosjen e sistemeve të matjes në njësitë e grumbullimit të burimeve, depove, stacionet e pompimit e rrjetet e shpërndarjes.

Brenda datës 31.06.2016

9. Nuk janë shfrytëzuar të gjitha burimet në rritjen e faturimit të ujit dhe në përmirësimin e cilësisë së ujit te konsumatorët. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr 14 -21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Përsa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga administratori për rritjen e faturimit të ujit dhe në përmirësimin e cilësisë së ujit te konsumatorët.

Menjëherë dhe vazhdimisht

10. Nuk janë lidhur kontratat e punës me punonjësit bazuar në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Kreu V” Krijimi i raporteve individuale të punës”, nenet 12-21 dhe të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nënpunësit civil”, neni 32/ç. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.22-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës që administratori i shoqërisë të lidhë kontratat individuale dhe kolektive me punonjësit e punësuar në zbatim të nenit 160 të Kodit të Punës.

Menjëherë

11. Nga auditimi i dosjes së procedurës së tenderit me objekt “*Rikonstruktion i Ujësjellësit Bulqizë, Rrjeti shpërndarës, faza e II-të, (Linja sekondare dhe terciare)*”, rezultuan këto problematika:

-Nga kryerja e procedurës së prokurimit:

Në lidhje me argumentimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në vendimin e marrë, mbi kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorëve ekonomikë rezultoi të jetë i pabazuar, pasi u bënë verifikimet në sistemin online të paraqitjes së dokumentacionit të subjekteve pjesëmarrjes

nga ku rezultoi se, operatori ekonomik “.....”sh.p.k., i cili në kontratën e ngjajshme për punime të së njëjtës natyrë të paraqitur elektronikisht, ka thujse në të gjithë preventivin e punimeve dhe zërat e njëjtë me punimet e preventivit të tenderit të zhvilluar nga SH.A UB. Në këtë pikë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.1.2007. Oferta e paraqitur e këtij operatori është në shumën prej 20,766,046 lekë pa t.v.sh., dhe si e tillë kjo ofertë është s’kualifikuar pa të drejtë, megjithëse është ofertë anomalisht e ulët dhe e krahasuar me preventivin e bërë nga shoqëria dhe manualët e cmimeve të ndërtimit, por nuk janë kërkuar shpjegime plotësuese mbi këtë ofertë nga operatori ekonomik. Diferenca e operatorit të përzgjedhur si fitues dhe operatorit të s’kualifikuar pa të drejtë është $(32,496,874 - 20,766,874) = 11,730,000$ lekë e cila përbën efekt financiar, për shoqërinë.

-Nga auditimi i dosjes së zbatimit të punimeve u konstatua se:

Sipas kontratës së lidhur me datë 01.10.2014, midis titullarit të SH.A Ujësjeles Bulqizë, dhe operatorit ekonomik fitues të tenderit ka përfunduar pjesërisht kryerja e punimeve dhe është likujduar në shumën prej 17,750,000 lekë për situacionin pjesor të punimeve. Referuar tabelave të mësipërme rezulton se ka diferenca në disa zëra punimesh. Situacioni pjesor pasqyron kryerjen e këtyre zërave punimesh, ndërkohë që nuk janë kryer, me argumentimin se nuk kanë përfunduar ende procesin e kryerjes së punimeve të Rikonstruksionit në këtë objekt.

-SH.A Ujësjeles Bulqizë, në zbatim të kërkesave të nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 1, germa b), të marrë masa, për të bërë të mundur trajnimin e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit Publik, nëpërmjet APP-së, në funksion të ngritjes së kapaciteteve që mbulojnë këto funksione.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

-SH.A Ujësjeles Bulqizë të marrë masa ku emërimet e anëtarëve të Njesisë së Prokurimit të cilët caktohen nga autoriteti kontraktor për një periudhë e cila shtrihet përgjatë vitit ushtrimor si dhe ndryshimet në këto emërimet, dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të cilët caktohen me urdhër të veçantë për prokurimet publike, të bëhen në përputhje me LPP nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

-Nga SH.A Ujësjeles Bulqizë, në zbatim të rregullave të LPP, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, gjithashtu në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Rregullat e prokurimit publik”, të marrë masat e duhura që të evidentojë në urdhërin e prokurimit si dhe në procesverbalet e mbajtura për çdo prokurim, në përcaktimin dhe argumentimin e saktë të vendrojeve, numrit të rojeve për çdo turn, përllogaritjen e fondit limit, njësinë e cila bën përllogaritjen, njësinë e cila harton specifikimet teknike, nevojën e kryerjes së procedurës, vendosjen e kriterëve të DST, etj për objektin që do të prokurojë.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

-SH.A Ujësjeles Bulqizë, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 2, germa ç), të marri masa, për caktimin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në funksion të ngritjes së kapaciteteve që mbulojnë këto funksione. Gjithashtu nga anëtarët e KVO-së të merren masa për të ardhmen, që

në rastet e procedurave të tenderave që do të kryhen në vazhdimësi, duke kaluar me rigorozitet të gjitha hapat që janë përcaktuar në LPP, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, gjithashtu në zbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Menjëherë dhe vazhdimisht

-Të merren masa, nga njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave që dosjet e operatorëve ekonomikë të merren dhe të dorëzohen me datë dhe protokoll nga subjektet pjesëmarrës.

Vazhdimisht.

-Të krijohet regjistri i prokurimeve, nga njësia e prokurimit dhe komisioni i vlerësimit të ofertave për evidentimin e procesverbaleve dhe çdo dokument që lidhet me objektin e tenderit që prokurohet në përputhje me LPP, kreu II, neni 12, pika 3.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

-Të merren masa, nga Titullari i SH.A Ujësjiellës Bulqizë, në lidhje me shërbimin e rojeve duke ngritur komision për mbikëqyrjen e saj, në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreut VIII “Ekzekutimi i kontratës”, pika 1, gërma d), dhe pika 2, gërma a) dhe b), dhe mbi bazën e raporteve dhe procesverbaleve të monitorimit nga komisioni i mbikëqyrjes së kontratës, të kryhet pagesa duke përlllogaritur dhe evidentuar problematikat gjatë kryerjes së shërbimit (nëse ka).

Menjëherë dhe vazhdimisht.

12. Nga analiza e llogarive/kërkesave të arkëtueshme rezulton se një pjesë e kërkesave janë pa shpresë arkëtimi, për të cilat duhej krijuar provizioni i tyre sipas Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës që administratori i shoqërisë bashkë me degën ekonomike të përpilojë provizionet sipas Standartit Kombëtar të Kontabiliteti nr.6.

Deri në fund të vitit 2015

13. Shoqëria nuk ka marrë masat për pajisjen me numër serial të aprovuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, për faturat e shitjeve duke ekspozuar kërkesat e arkëtueshme në rrezik mosmbledhje të tyre. Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si Titull Ekzekutiv”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës që administratori i shoqërisë të pajisë shoqërinë me numër serial të aprovuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, për faturat e shitjeve.

Deri në fund të vitit 2015

14. Nga verifikimi i të dhënave u konstatua se nuk disponoheshin certifikata pronësie për asetet afatgjata të shoqërisë, sipas vendimit nr.809, datë 26.11.2004 për transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa, nga Shoqëria për kryerjen e të gjitha procedurave të nevojshme për regjistrimin e pasurive pranë ZRPPV.

Deri në fund të vitit 2015

15. Shoqërisë i është shkaktuar një efekt financiar negativ për vlerën 8,459,932 lekë me gjoba dhe kamatëvonesa për mospagesë të taksave dhe tatimeve ndër vite. Gjithashtu në bilanc detyrimet për tatim taksa janë në vlerën 10,125,211 lekë duke pasur një diferencë prej 16,165,966 lekësh me vlerën që rezulton në sistemin e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Dibër. Përgjegjësi për këto efekte financiare negative mbajnë administratorët e shoqërisë në këto vite duke mos marrë masat e duhura për pagesat në kohën e duhur të detyrimeve të shoqërisë si dhe për mosparaqitjen e tyre në pasqyrat financiare.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.60-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës që administratori i shoqërisë të kryejë pagesat për detyrimet për tatime e taksa si dhe paraqitjen e saktë të tyre në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Deri në fund të vitit 2015

16. Shoqëria nuk ka kartela përkatëse për cdo material, por ka vepruar sipas regjistrit të magazinës. Kodifikimi i materialeve është bërë sipas çmimit të materialeve dhe jo sipas specifikimeve teknike. Nuk është fiksuar para fillimit të inventarit numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit. Nga komisioni i inventarizimit nuk janë mbajtur raportet e inventarizimeve.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë, dhe dega e financës që në vazhdimësi për materialet që bëhen hyrje në magazine të regjistrohen në kartela dhe të bëhet kodifikimi i tyre, në zbatim të UMF nr.30, date 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Deri në fund të vitit 2015.

17. Ujësjellës Sha Bulqizë ka në inventarin e aseteve të saj ujësjellësin e Fushë Hudrës. Nga verifikimi i bërë në objekt u konstatua se në një pikë të tubacionit të ujësjellësit shoqëria sh.p.k. ka ngritur një central për prodhimin e energjisë elektrike duke shfrytëzuar të gjithë kapacitetin e prurjeve të ujit.

Shoqëria ka shfrytëzuar linjën dhe asetet e ndërtuara nga ujësjellësi për sjelljen e ujit nga burimi pranë qendrës së banuar ku është dhe stacioni i prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie. Për shfrytëzimin e kësaj pasurie nuk është lidhur asnjë marrëveshje dhe shoqëria nuk ka kryer asnjë pagesë në kundërshtim me vendimin Nr.529, datë 8.6.2011”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë

apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” duke krijuar një të ardhur të munguar prej **242,206 lekë**.

Shoqëria ka vepruar në kundërshtim me ligjin Nr. 8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”.

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Adminisrimit të Ujërave nuk ka penalizuar këtë shkelje të kryer nga kjo shoqëri, e cila e parashikuar në nenin 26, pika 3 dënohet me 2,000,000 lekë gjobë.

Gjithashtu ky akt lidhet me Neni 159 të Kodit Penal “Shkatërrimi i rrjetit të ujësjetllësit”.
(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.70 -73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga këshilli mbikëqyrës dhe administratori i shoqërisë, për kryerjen e të gjitha procedurave nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Adminisrimit të Ujërave për penalizimin e shkeljes së kryer nga shoqëria, e cila e parashikuar në nenin 26, pika 3 dënohet me 2,000,000 lekë gjobë.

Deri në fund të vitit 2015

-Titullari i shoqërisë duhet të marrë masa për devijimin e tubacionit të furnizimit me ujë nga impianti i Hec-it të shoqërisë, në Fushë Hutër duke siguruar cilësinë dhe parametrat e kërkuar nga kodi i ujit.

Deri në 30.04. 2016

18. Administratori i shoqërisë z. ka lidhur kontratën për shërbimin e rojeve private me “.....” sh.p.k., në vitin 2014, në mënyrë të jashtëligjshme dhe jashtë afateve të përfundimit të kontratës së mëparëshme si dhe nuk ka kryer procedurë prokurimi, dhe ka kryer pagesa pa dokumentacion justifikues, në vlerën **1,599,695 lekë**.

-Janë bërë pagesa për udhëtim e dieta në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010 në 16 raste me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 40,000 lekë.

-Janë kryer pagesa të pajustificuara me dokumente autorizues, vërtetues dhe verifikues me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 36,600 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.74 -82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Sh.A Ujësjetllës Bulqizë që në bazë të nevojave për mallra dhe shërbime të hartohet regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve dhe të paraqiten pranë Agjencisë së Prokurimit Publik.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

-Të merren masa, nga Titullari i SH.A UB për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve të kryera, të marjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara për çdo rast, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ”, pika 42.

Vazhdimisht.

-Të merren masa nga Autoriteti Kontraktor që procedurat e prokurimeve për blerjet me vlera të vogla të kryhen konform kërkesave të përcaktuara në dispozitat ligjore të sipërcituara, për të shmangur parregullsitë që cojnë në fiktivitet të procedurave.

Vazhdimisht.

-Të merren masa, nga komisioni i vlerësimit të ofertave që të njihen me LPP dhe VKM nr. 1, "Për prokurimin publik", dhe të zbatohen të gjitha procedurat e tij sipas kërkesave, si dhe në rastin e mësipërm në përputhje me VKM nr.1, datë 10.01.2007, kreu V, pika 4, gërma b).

Vazhdimisht.

-Të merren masa nga Drejtoria e shoqërisë, dhe dega e financës që në vazhdimësi për materialet që bëhen hyrje në magazine të regjistruhen në kartela dhe të bëhet kodifikimi i tyre, në zbatim të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Menjëherë dhe vazhdimisht.

-Strukturat e degës ekonomike të SH.A UB, të marrin masa që përpara se të kryejnë likuidimet e shërbimeve ose të punimeve, të kërkojnë bashkangjitur faturës tatimore dokumentet justifikues të kryerjes së tyre.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

19. Shoqëria SHA Ujësja e Bulqizës, nuk ka të përcaktuar misionin, strategjinë dhe objektivat, në hartimin e planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

-Mungon plani i veprimeve të SHA UK Bulqizë, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik.

-Në këtë Shoqëri stafi drejtues nuk ka njohje të ligjit dhe koncepteve të tij.

-Nga menaxheri i shoqërisë nuk njihen komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit me qëllim zbatimin sa më të mirë të tyre në praktikë për menaxhimin e riskut.

-Pavarësisht hartimit dhe miratimit të strukturës organizative vërejmë se nuk është ngritur njësi juridike, si pasojë e të cilës stafi i shoqërisë nuk ka njohuri mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

-Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi paraprak, raportimi, analiza e risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Nuk ka të miratuar një strategji konkrete të rrisqeve.

-Nuk është hartuar regjistri i riskut, ku të jenë përcaktuar nivelet e riskut para kontrollit dhe pas kontrollit sipas fushave të përcaktuara.

-Nuk ekzistojnë procedura të punës të shkruara për proceset kryesore operationale dhe financiare, duke përfshirë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollin e brendshëm. Gjithë këta aktivitete i janë nënshtruar dhe dispozitave ligjore në fuqi.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.83 -85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Shoqëria për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues i ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik. Në planet konkrete të veprimit të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Brenda vitit 2015

-Të merren masa nga Shoqëria për vendosjen e procedurave të punës të shkruara për proceset kryesore operationale dhe financiare, duke përfshirë dhe qarkullimin e dokumentacionit dhe të informacionit, hallkat e vendim-marrjes dhe kontrollet e brendshme. Gjithë këta aktivitete i nënshtrohen dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Brenda vitit 2015

20. Nga kjo shoqëri, nuk është mbajtur ditari i regjistrimit të të dhënave të prodhimit dhe grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve sh.a”, dhe VKM nr. 145, datë 26.02.1988 “Për miratimin e rregullores higjeno-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.86 -87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të merren masa nga Shoqëria për mbajtjen e ditarit të regjistrimit të të dhënave të prodhimit dhe grumbullimit, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura urbane, komerciale dhe industriale.

Menjëherë dhe vazhdimisht.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

21. Nga auditimi i dosjes së tenderit për shërbimin e rojeve për vitin 2014 rezultoi se, në muajin gusht, ka nisur procedura e prokurimit. Nuk ka dalë urdhër prokurimi për kryerjen e procedurës, urdhër mbi përllogaritjen e fondit limit, anëtarët e caktuar për KVO nuk kanë arsimin e duhur apo të jenë specialistë të fushës, duke vepruar në kundërshtim me rregullat e LPP, nr 9643, datë 20.11.2006“Për prokurimin Publik” i ndryshuar.

Kjo procedurë është anuluar nga titullari i Autoritetit Kontraktor, me argumentin se sistemi ka problematika dhe nuk bëhet përditësimi i kriterëve të pjesëmarrjes, por nuk ka vazhduar më tej në ditët në vazhdim kryerja e procedurës.

Në muajin Tetor 2014, ka rinisur sërish kryerja e procedurës së mësipërme me të njëjtat të dhëna dhe ka dalë urdhër nga titullari i AK, për anulimin e kësaj procedure në zbatim të vendimit të KPP nr. 599/2014, datë 12.11.2014, i cili ka vendosur që të anulohet procedura e këtij prokurimi për shkak të ndryshimit të pagës bazë për rojet e shërbimit të sigurisë fizike, pasi duhet ndryshuar përllogaritja e fondit limit.

Në muajin dhjetor 2014, ka filluar sërish kryerja e procedurës së tenderit për rojet por me objekt e fond limit të ndryshuar ku rezultuan mungesa e urdhërit për kryerjen e procedurës së prokurimit, e urdhërit për përlogaritjen e fondit limit, argumentimi se përse është shtuar një vendroje (Kreshtë e Cupe), duke i shkaktuar një rritje fiktive të fondit limit prej **1,872,000 lekësh, e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë**. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr.24 -59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohen në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e vlerës **1,872,000 lekë**, nga z., me detyrë administrator i shoqërisë, për shkeljet e konstatuara në procedurën e tenderit për shërbimin e rojeve për vitin 2014. Dëmshtërimi mbështetet në nenin 31 e 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë.

22. Revokuar me shkresë nr. 513/12 datë 22.12.2015.

23. Janë bërë pagesa për udhëtim e dieta në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 në 16 raste me pasojë dëm ekonomik në vlerën **40,000 lekë**. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr.74 -82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **40,000 lekë** në 16 raste, si përfitim i padrejtë, nga personat përfitues (në mënyrë të detajuar, aneksi nr.1 i Raportit Përfundimtar i Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

Menjëherë.

24. Janë kryer pagesa të pajustificuara me dokumente autorizues, vërtetues dhe verifikues me pasojë dëm ekonomik në vlerën **36,600 lekë**, në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. (Trajtuar më hollësisht në faqet nr.74 -82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit). Dëmshtërimi mbështetet në nenin 31 e 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet shpërblimi i shumës prej **36,600 lekë** nga administratori i SH.A Ujësjellës Bulqizë, z....., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, i kërkojmë Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, që në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, të ndërmarrin masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë nisjen e procedurave disiplinore, për:

“Zgjidhje të kontratës së punësimit” për:

1. me detyrë drejtues i shoqërisë.

Për arsye se:

-Në lidhjen e kontratës së tenderit të zhvilluar me objekt: “Shërbim i ruajtës me roje ”, për vitin 2013 rezultoi një diferencë në përlllogaritjen e fondit limit në vlerën **1,872,000 lekë**.

-Për moszbatim të ligjit 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, për lidhjen e kontratës me shoqërinë “.....” në vitin 2014, pa kryerjen e procedurës së prokurimit.

Raporti përfundimtar i auditimit të analizohet në shoqërinë sh.a Ujësjiellës Bulqizë dhe të merren masat e nevojshme administrative dhe disiplinore për personelin sipas përgjegjësive respektive të cituara ne raportin e auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave të aplikuara më parë.

KLSH nuk rekomandon masa konkrete, për arsye sepse kjo shoqëri nuk disponon kontratën kolektive dhe kontratën individuale të punës ku të jenë të përcaktuara masat disiplinore.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Blerin Shkurti, Erion Muho, Odeon Smajli, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Iliazi, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Departamentit Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.